

Zbulimi i Bustit të Tahir Jahës, Kryetar Nderi i Kryqit të Kuq të Kosovës

Me vendimin e Kryesisë së KKK-së me 08.04.2009 u bë zbulimi i bustit të Tahir Jahës, Kryetar Nderi i KKK-së.

Me këtë rast u mbajt një manifestim në të cilin morën pjesë, familja, shumë veteranë, bashkëpunëtorë, miq të Tahir Jahës dhe të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Kryetari i KKK Prof. Dr. Xhevat Shkodra bëri një përmbledhje të shkurtër biografike të veprimtarisë së tij në Kryqin e Kuq të Kosovës.

Tahir Jaha, me biografinë e pasur të një intelektualit dhe humanisti e bënë Kryqin e Kuq të krenohet dhe ta kujtojë me pietet personalitetin e Kryetarit të Nderit, me ımburrje përkujton veprat dhe aktivitetin e tij në Kryqin e Kuq, është njeriu që la

gjurmë të pashlyeshme dhe emblematike në Kryqin e Kuq të Kosovës.

Shkrimet e tija letrare e indentifikojnë karakterin dhe ndjenjat e tij.

Jo rastësisht nuk thuhet se shkrimtarët ndërtojnë ura ndërlidhëse, miqësie ndërmjet njerëzve. Pas shumë shkëputjeve dhe vështirësive nuk është e rastit që Tahir Jaha vazhdon punën në Kryqin e Kuq.

Vijimisht u përpoq të inkuadrojë dhe të aktivizojë njerëzit e shquar dhe me autoritet qytetar për Kosovën dhe joshjen e tyre për në Kryqin e Kuq. Këtë angazhim të tij ne edhe sot e quajmë "Shkolla e Tahir Jahës"

Me iniciativën e tij u themelua qendra trajnuese për përhapjen e njohurive për KK dhe Lëvizjen, në pushimoren e Deçanit, qëllimi i së cilës ishte

rekrutimi i juniorëve dhe të rinjve në KKK.

Nga ky angazhim i tij ne edhe sot kemi kuadra-vullnetar me peshë në Kryqin e Kuq e që ne i identifikojmë "Që nga koha e Tahir Jahës"

Andaj në shenjë përkujdesjeje dhe respekti të përhershëm për njeriun dhe humanistin e madh Kryqi i Kuq i Kosovës bashkë me veprat do t'a ketë pranë në përherëshmëri që nga dita e sotme me bustin në gjirin e objektit të tij si më të merituarin dhe të paharruarin Tahir Jahën. Respekt për të madhin Tahir dhe familjen e tij.



Biografia e Kryetarit të Nderit të KKK



TAHIR JAHA
1913 - 2003

Tahir Jaha

Tahir Jaha u lind më 13 mars 1913, në Babaj të Bokës, afër Gjakovës, në një familje fshatare. Kur ishte fëmijë familja e tij kaloi në Shqipëri. Tahiri shkollën fillore e kreu në Krumë kurse njëkohë vijoi mësimet në Gjimnazin e Shkodrës. Por për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të familjes, mësimet i ndërpreu dhe filloi të punojë për kafshatë të gojës. Më 1942 u kthye në Kosovë dhe menjëherë u vu në lidhje me Lëvizjen Nacional Çlirimtare në Prizren ku mori pjesë në mënyrë aktive në këtë Lëvizje.

Si drejtor i shtypshkronjës (1952 – 1956) bëri përpjekje të vetmohueshme për mëkëmbjen e kuadrit profesional, ndërtimin e godinës dhe paisjeve teknike të shtypshkronjës, për të mundësuar zhvillimin e shtypit në Kosovë, të "Rilindjes", revistave, veprimtarisë botuese, revistave, ilustrimeve etj., i frymëzuar nga motoja e tij "Në kullën e shtypit dielli lind më herët".

Me shkrime letrare merret qysh gjatë luftës. Sshkruan poezi dhe prozë, ka disa vepra të botuara me tituj shumë karakteristike si: "Mos prek në strajcë të fukarasë", "Bukën në lis çerdhen në shkrepë", etj. Këta tituj e identifikojnë karakterin dhe ndjenjat e tij.

Andaj, nuk është e rastit që Tahir Jaha, e vazhdon punën e vet në Kryqin e Kuq të Kosovës, sepse shpirti i tij human i ndrydhur me vite pas luftës "shpërthen" me shkrime dhe punë edhe në Kryqin e Kuq të Kosovës.

Kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës ishte prej vitit 1962 deri më 1981, kohë kur Kosova dhe KKK-ja angazhoheshin për t'u dëshmuar me punën e mirëfilltë të nevojshme dhe të dobishme për popullatën.

Përveç punës, që bën si Kryetar dhe përfaqësimin e denjë të Kryqit të Kuq të Kosovës në atë kohë, në vazhdimësi ishte i përkushtuar për angazhimin e njerëzve intelektual, të shquar dhe me autoritet qytetar për Kosovën (si: profesorë të universitetit, mjekë e intelektualë e tjerë) e në veçanti, joshjen dhe përfshirjen e të rinjëve për angazhim në KKK.

Mbi të gjitha e kishte ndjenjën për të ndihmuar nevojtarët, këtë trashëgimi e kultivoi dhe ua la amanet familjes, por edhe njerëzve në Kryqin e Kuq.

Tahir Jaha është shpallur Kryetar Nderi i Kryqit të Kuq të Kosovës, në Kuvendin e Parë Zgjedhor të pasluftës, mbajtur më 21 janar 2001.